# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-468041**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Të shkrihet Gjykata Speciale”, ish-këshilltari i Trump për Sigurinë flet për Hagën dhe dënimet ndaj ish-krerëve të UÇK |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/te-shkrihet-gjykata-speciale-ish-keshilltari-i-trump-per-sigurine-flet-pe-i588269` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 08:34:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 08:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `078a20c7d4cc0f748573e8dea3fec25b69394fb8ba6030cf2cef923b06bc77bc` |
| TEKSTI | `c40b22c9825ae9af5d1a17d06d3bc66fc86edbfc7814771f169208fe6e3fb49f` |
| PAMJA | `26bfd3f08c3dc1f7bb345bafbe783311b6d3a571a5035ec4dab06b2b9fc1465a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ed03d24430ba9f5f0af1fde0fd7afc5f86a1d9b338ef2e16dae799bcf6198857` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdfe651dfbc0b1533` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ed03d24430ba9f5f0af1fde0fd7afc5f86a1d9b338ef2e16dae799bcf6198857`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Të shkrihet Gjykata Speciale", ish-këshilltari i Trump për Sigurinë flet për Hagën dhe dënimet ndaj ish-krerëve të UÇK

TemA

25 Shtator 2026, 10:30Rajoni TEMA




Ish-këshilltari i Trump për Sigurinë Kombëtare, John Bolton, është shprehur për shkrirjen e Gjykatës Speciale, duke deklaruar se proceset ndaj ish-krerëve të UÇK-së kanë një element të rëndë politik.

Në një intervistë për emisionin "Off the Record" nga Andrea Danglli në A2CNN, Bolton e cilësoi institucionin të paligjshëm, ndërsa ngriti shqetësime për mungesën e mbikëqyrjes dhe pasojat që mund të ketë kjo për drejtësinë.

Ai argumentoi se një zgjidhje më e përshtatshme do të ishte që vetë shtetet, përfshirë Kosovën dhe Serbinë, të hetonin dhe të gjykonin ish-liderët e tyre përmes sistemeve të pavarura të drejtësisë.

"*Pikëpamja ime është që këto gjyqe kanë patur një element të rëndë politik dhe nuk është një pyetje abstrakte për të kërkuar drejtësi, për çdo kënd që është i përfshirë në konflikt. Pikëpamja ime për një kohë të gjatë ka qenë është që nëse e merr këtë si shembull, që ilaçi më i mirë për ato lloj sjellje nga ish-drejtuesit, në rastin e Serbisë, është që të bëjnë ata vendimin për të hetuar dhe dënuar ish-liderët e tyre, po ashtu me Kosovën, për të përfunduar konfliktin dhe çfarë do që palët duhet të vënë mbrapa shpatullave të tyre, për të kërkuar atë drejtësi, që vetëm një tribunal i pavarur mund ta bëjë, mendoj që nuk është e duhura.*

*Të shkuarën me të harruarën, nuk besoj se është forma e duhur, por duhet të arrijë një kohë, kur kjo është e vetmja mënyrë si mund ta bësh. Më e mira është të shikojmë drejt së ardhmesh, dhe kjo mund të jetë përgjigjja e duhur, nuk po e paragjykoj por mendoj se nëse inkurajon pjekurinë politike, duke patur vendet që të gjykojnë vet ish-liderët e tyre, nëse kanë bërë gjënë e duhur, apo kanë bërë gabime nga një trup që është e pavarur, nuk kemi për ta parë asnjëherë fundin*", tha Bolton.

I pyetur a po krijon Haga precedent të rrezikshëm për të gjitha lëvizjet çlirimtare në botë, Bolton u shpreh:

"*Është e mundur, por njerëzit e kanë humbur interesin te trupi gjykues dhe ideja që vendet që e kanë ngritur trupin gjykues, do ta supervizonin, kjo është zhdukur dhe për mua kjo shkon te paligjshmëria e këtij institucioni, dhe nuk reflektojnë çfarë Amerika beson për një kohë të gjatë, që e vetmja mënyrë korrekte, e duhur, për të bërë drejtësi, është nëpërmjet një sistemi të drejtësisë nga shtetet e pavarura si për sistemin e prokurorisë dhe gjyqësorin. Mendoj që kjo gjykatë është e paligjshme dhe shembujt që po jepni demonstron që trupi, prokuroria, kanë bërë gabimet e tyre*".

Pyetjes: Pra mendoni që gjykata duhet të shpërbëhet një orë e më parë, Bolton iu përgjigj:

"*Sigurisht. Ka qenë një kohë e gjatë që prej shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, dhe të mendosh në një pikë që mund ta quash këtë një fund, singerisht s'jam i sigurt që vendet që e kanë krijuar këtë gjykatë... Nëse dikush është i pakënaqur, nëse Kosova është e pakënaqur, duhet të flasin dhe ta thonë që kemi arritur kufijtë e tolerimit. I ka tejkaluar kufijtë e asaj që mendonim dhe kishim rënë dakord. Dikush duhet ta kuptojë që këto trupa gjykuese kur u krijuan nuk ishin kaq virtuoze sepse ishin ndërkombëtare, dhe që mungesa e mbikëqyrjes mund të çojë drejt rrethanave ku ato humbasin rrugët dhe shkojnë në drejtime që askush s'i kishte menduar dhe shkaktojnë dëme. Duke u fokusuar në mendjengushtësi, për akuzat e gabimeve gjatë luftës, siç e bënë, japin mundësinë për mospajtim dhe heqin dorën nga çfarë do lloj përgjegjësie dhe forme papërgjegjshmërie që liderët kanë bërë në të kaluarën*".

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Serbët e Kosovës mes listës së Vuçiqit dhe asaj studentore]

09:40 Rajoni

[Armët nga Bosnja dhe lidhjet e rrjeteve kriminale në Suedi me Iranin]

08:30 Rajoni / 1 koment

Vuçiç: Do të jap dorëheqjen të dielën, por do të flas me Putinin para përfundimit të mandatit

08:10 Rajoni

Kontrabanda e cigareve në Maqedoninë e Veriut, 13 të ndaluar mes tyre policë e doganierë, i shkaktuan shtetit 6 mln euro dëm

19:15 Rajoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.